

Kuvendi Komunal Dragash

Drejtoria- Ekonomi Financa dhe Zhvillim

Njoftim

Në harmoni me Ligjin mbi Tatimin në Pronën e Paluajtshme Nr. 06/L-005, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me 26 Janar 2018 , ju njoftojme se nga data 1 janar e vitit 2019 do të fillojë zbatimi i Ligjit mbi Tatimin në Pronën e Paluajtshme, i cili është i kategorizuar në pronë bujqësore, banesore, komerciale, pyjore, industriale dhe publike. Për here të parë do të aplikohet dhe tatimi në pronë bujqësore dhe pyjore . Vitin e parë, gjatë vitit 2019 do të tatimohen 20% e vlerës së pronave (bujqësore dhe pyjore) dhe do të llogaritet tatimi në vlerën më të ulët të mundshme 0,15%, që mos të rrezikohet gjendja financiare e banoreve në komunën tonë.

Të gjitha mjetet e inkasuara-paguara nga tatimi në pronë, do të shfrytëzohen për rregullimin dhe përmirësimin e infrastrukturës në Komunën e Dragashit.

Tatimi do të paguhet në dy keste dhe atë: kësti i parë deri me 30 prill 2019 dhe kësti i dytë deri me 30 shtator 2019

Ju njoftojmë se obligimet që kanë dale nga Ligji për Tatimin në Pronën e Paluajtshme të paguani në afatet e parapara me ligj në mënyrë që të mos paguani kamatë dhe ndeshkime të ndryshme për mospages të tatimeve. Mjetet e grumbulluara nga tatimi në pronë do të perdoren për mireqenjen e banoreve të komunës tone

Për më shumë informacione, mund të vizitoni zyrën e Tatimit në Pronë në Komunën e Dragashit.

Ju falemderit për mirëkuptim dhe bashkëpunim.

Drejtorati për Ekonomi Financa dhe Zhvillim

Zyra e Tatimin në Pronë